


PRISHTINË, SHKURT 2020

INTEGRITETI AKADEMIK DHE PUBLIKIMI SHKENCOR NË UNIVERSITETIN E PRIZRENIT



UNIVERSITETI
I PRIZRENIT



INTEGRITETI
AKADEMIK
DHE PUBLIKIMI
SHKENCOR NË
UNIVERSITETIN
E PRIZRENIT

Publikues:

ORCA - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

www.orca-ks.org

info@orca-ks.org

Simon Shiroka, H-11, Nr. 8

Prishtina, 10000, Kosova

Hulumtues:

Skord Retkoceri

Autorë:

Skord Retkoceri

Liridona Ademaj



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë
gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë.
Falna durimin të thellojmë një punë përpara
se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një
ndjenë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo
vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu!
Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga
shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e
shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

PËRMBAJTJA

Definime.....	7
Hyrje.....	8
Të dhënat e përgjithshme.....	9
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike.....	13
Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit	15
Fakulteti i Edukimit.....	17
Fakulteti Juridik	19
Fakulteti Ekonomik.....	21
Fakulteti i Filologjisë	23
Metodologjia e hulumtimit të punimeve shkencore.....	25
Metodologjia e hulumtimit të justifikimit të titujve.....	28

DEFINIME

Punime me koeficient – konsiderohen punimet e publikuara në revista siç është përcaktuar me ligjet dhe rregullativat në fuqi

Pjesëmarrje në punime – punimet ku profesorët marrin pjesë si autorë pavarësisht renditjes, pra jo vetëm si autor i parë apo korrespondent

Punime në revista të dyshimta – punimet të cilat janë të listuara në listën Beall

Justifikimi i titullit – të pasurit e numrit të nevojshëm të publikimeve shkencore për titullin përkatës sipas ligjeve dhe rregullativave në fuqi

Burra dhe gra – Gjinia e presupozuar e personave në bazë të emrit pa paragjykuar identifikimin e tyre personal

HYRJE

Nevoja e publikut për t'u informuar rreth cilësisë së universiteteve publike të cilat pjesën dërmuese të fondeve e marrin nga paratë e taksapaguesve, bëri që ORCA të fillojë hulumtimet e ngjashme me ato që janë zhvilluar për 3 vite të plota në Universitetin e Prishtinës, në të gjitha universitetet tjera publike.

Raporti është rezultat i punës hulumtuese të bërë gjatë periudhës kohore qershor – tetor 2019, ku hulumtuesit e ORCA-s shqyrtuan materialet e publikuara në CV-të e stafit akademik të Universitetit të Prizrenit me titujt profesorial: profesor asistent, profesor i asocuar dhe profesor i rregullt.

Siç mund të ishte e pritshme, rezultati nuk është i kënaqshëm, por një analizë e tillë mund të jetë e dobishme për ta planifikuar reformën e ardhshme apo edhe për të marrë ndonjë veprim tjetër, si masë për sanimin e situatës.

Numri i vogël i punimeve shkencore, të publikuara në revista të mirëfillta nga profesorët si autorë të parë ose korrespondentë dhe numri i madh i punimeve në revista të dyshimta, tregon se presioni për publikim në njërin anë, e mosfinancimi i projekteve shkencore në anën tjetër, kanë shtyrë shumicën e profesorëve drejt situatës ku publikojnë sa për të publikuar.

E gjithë kjo, ka prodhuar një realitet ku publikimi në revista të dyshimta është bërë fenomen e jo përjashtim siç do të duhej të ndodhte.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME


Universiteti i Prizrenit ka 56 profesorë që i kanë publikuar CV-të e tyre në faqen e Universitetit, 42 (75%) prej të cilëve janë burra dhe 14 (25%) janë gra. 13 profesorë janë të asocuar, 43 janë profesorë asistentë. Universiteti i Prizrenit nuk ka asnjë profesor të rregullt, sipas CV-ve të publikuara në faqen zyrtare.

PUBLIKIMI I PUNIMEVE ME KOEFICIENT

Nga viti 2006 deri në vitin 2019, profesorët e Universitetit të Prizrenit kanë publikuar në total 55 punime me koeficient, si autorë të parë ose korrespondentë. Numri i pjesëmarrjes në punime me koeficient është 66. Pjesëmarrja në punime paraqet numrin e punimeve ku profesorët marrin pjesë si autorë pavarësisht renditjes, pra jo vetëm si autor i parë apo korrespondent

Nga 56 profesorë, 31 apo 55% prej tyre nuk kanë asnjë punim me koeficient si autor i parë apo korrespondent. Për krahasim, në Universitetin e Prishtinës në vitin 2018, 208 apo 45% e profesorëve nuk kanë asnjë punim si autor i parë apo korrespondent.

PUNIMET NË REVISTA ME KOEFICIENT SI AUTOR I PARË APO KORRESPONDENT



Fakulteti me më së shumti punime me koeficient është Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit. Pjesëmarrja në punime arrin numrin 25, me mesatarisht 3.6 punime për profesor. Ndërsa numri i punimeve, si autor i parë apo korrespondent, arrin në 20, me mesatarisht 2.8 punime për profesor.

Fakulteti me më së paku punime është Fakulteti Juridik. Numri i punimeve, si autor i parë apo korrespondent, është vetëm 2, me mesatarisht 0.3 punime për profesor. Në këtë fakultet nuk ka pjesëmarrje në punime të tjera.

Mesatarja e punimeve, si autor i parë apo korrespondent, për profesor në nivel universiteti është vetëm 0.9. Ndërsa sa i përket pjesëmarrjes në punime, në nivel universiteti, mesatarja e punimeve për profesor është 1.2.

Punimet me koeficient sipas fakulteteve

Fakulteti	Nr. i profesorëve	Pjesëmarrja në punime	Punime për kokë profesori (pjesëmarrje në punime)	Nr. i punimeve (autor i parë/korrespondent)	Punime për kokë profesori (autor i parë/korrespondent)
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	7	14	2	14	2
Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit	7	25	3.6	20	2.8
Fakulteti i Edukimit	11	11	1	6	0.5
Fakulteti i Filologjisë	11	9	0.8	9	0.8
Fakulteti Ekonomik	13	5	0.4	4	0.3
Fakulteti Juridik	7	2	0.3	2	0.3
TOTAL	56	66	1.2	55	1

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA


Numri i përgjithshëm i punimeve në revista të dyshimta është 120. Këto punime, janë publikuar në periudhën kohore 2008 - 2019.

Nga 56 profesorët, 37 apo 66% kanë publikuar në revista të dyshimta. Prej tyre 12 i justifikojnë titujt akademikë ndërsa 25 nuk i justifikojnë titujt akademikë.

Më së shumti publikime në revista të dyshimta ka Fakulteti Ekonomik ku 11 profesorë kanë botuar 46 sosh.

Viti 2016 shënon pikun e publikimeve në revista të dyshimta me 35 punime. Në vitet në vijim ka një rënie drastike të publikimeve në revista të dyshimta. Në vitin 2019 janë publikuar vetëm 4 punime të tilla.

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Nga 56 profesorë, 20 (36%) i justifikojnë titujt sipas kriterit të punimeve shkencore me koeficient, ndërsa 36 (64%) nuk i justifikojnë titujt. Për krahasim, mosjustifikimi i titujve në UP në vitin 2018 ishte 59%.

Nga 20 profesorë që i justifikojnë titujt, 17 janë profesorë asistentë dhe 3 janë profesorë të asocuar.

Nga 36 profesorë që nuk i justifikojnë titujt, 25 janë profesorë asistentë dhe 11 janë profesorë të asocuar.

Fakulteti me më së shumti justifikime të titujve është Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, ku vetëm një profesor nuk e justifikon titullin nga 7 gjithsej.

Në anën tjetër, fakulteti me justifikimin më të ulët të titujve është Fakulteti Juridik, ku vetëm një profesor justifikon titullin nga 7 gjithsej.

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Prizrenit	Profesorët që i justifikojnë titujt			Profesorët që nuk i justifikojnë titujt		
		Prof. ass	Prof. asoc.	Prof. rreg	Prof. ass	Prof. asoc.	prof. rreg
1	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	3	2	0	1	1	0
2	Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit	5	1	0	1	0	0
3	Fakulteti i Edukimit	4	0	0	5	2	0
4	Fakulteti i Filologjisë	2	0	0	7	2	0
5	Fakulteti Ekonomik	2	0	0	6	5	0
6	Fakulteti Juridik	1	0	0	5	1	0
TOTAL		17	3	0	25	11	0
		20			36		

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE




Fakulteti i Shkencave Kompjuterike ka gjithsej **7 profesorë**, **5** prej të cilëve janë **burra** dhe **2 janë gra**. **3 profesorë** janë të asocuar, ndërsa **4 janë profesorë asistentë**. Të gjithë profesorët e asocuar janë burra, ndërsa tek profesorët asistentë, **1** është **burrë** dhe **2 janë gra**.

PUBLIKIMI ME KOEFICIENT

Ky fakultet numëron gjithsej 14 punime me koeficient, të publikuara nga profesorët si autorë të parë ose korrespondentë. Pjesëmarrja në punime me koeficient¹ është po ashtu 14. Punimet janë publikuar nga viti 2011 deri në vitin 2018.

PUBLIKIMI NË REVISTA ME KOEFICIENT




¹ Pjesëmarrja në punime paraqet numrin e punimeve ku profesorët marrin pjesë si autorë pavarësisht renditjes, pra jo vetëm si autor i parë apo korrespondent

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA

Profesorët në këtë fakultet, kanë publikuar gjithsej 12 punime në revista të dyshimta në periudhën kohore 2013 – 2019.

Këto punime janë publikuar nga 4 profesorë, 3 që i justifikojnë titujt dhe një që nuk e justifikon titullin. 2 prej profesorëve janë të asocuar dhe 2 janë profesorë asistentë. Të gjithë profesorët që kanë botuar në revista të dyshimta janë burra.

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Prej 7 profesorëve, 5 i justifikojnë titujt akademikë dhe 2 nuk i justifikojnë titujt. Nga ata që i justifikojnë titujt, 2 janë të asocuar dhe 3 janë profesorë asistentë; 4 janë burra dhe një është grua. Ndërsa në radhët e profesorëve që nuk i justifikojnë titujt, një është i asocuar dhe një është asistent; një është burrë dhe një është grua.

Profesorët që i justifikojnë titujt			Profesorët që nuk i justifikojnë titujt		
Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg	Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg
3	2	0	1	1	0

FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT




Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit ka **7 profesorë**, **6** prej të cilëve janë **burra** dhe **një** është **grua**. Një profesor është i asocuar, ndërsa **6** janë **profesor asistentë**. Profesori i asocuar është **burrë**, ndërsa tek profesorët asistentë, **5** janë **burra** dhe **një** është **grua**.

PUBLIKIMI I PUNIMEVE ME KOEFIICIENT

Ky fakultet numëron gjithsej 20 punime me koeficient, të publikuara nga profesorët si autorë të parë ose korrespondentë. Pjesëmarrja në punime me koeficient² është 25. Punimet janë publikuar nga viti 2008 deri në vitin 2019.

PUBLIKIMI NË REVISTA ME KOEFIICIENT




² Pjesëmarrja në punime paraqet numrin e punimeve ku profesorët marrin pjesë si autorë pavarësisht renditjes, pra jo vetëm si autor i parë apo korrespondent

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA

Profesorët në këtë fakultet, kanë publikuar gjithsej 14 punime në revista të dyshimta në periudhën kohore 2011 – 2017.

Këto punime janë publikuar nga 5 profesorë, 4 që i justifikojnë titujt dhe një që nuk e justifikon titullin. Një prej profesorëve është i asocuar dhe 4 janë profesorë asistentë. Të gjithë profesorët që kanë botuar në revista të dyshimta janë burra.

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Prej 7 profesorëve, 6 i justifikojnë titujt akademikë dhe një nuk e justifikon titullin. Nga ata që i justifikojnë titujt, një është i asocuar dhe 5 janë profesorë asistentë; 5 janë burra dhe një është grua. Një profesor asistent burrë, nuk e justifikon titullin.

Profesorët që i justifikojnë titujt			Profesorët që nuk i justifikojnë titujt		
Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg	Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg
5	1	0	1	0	0

FAKULTETI I EDUKIMIT




Fakulteti i Edukimit ka **11 profesorë**, **7** prej të cilëve janë **burra** dhe **4** janë **gra**. **2 profesorë** janë të asocuar, ndërsa **9** janë **profesor asistentë**. Të gjithë profesorët e acocuar janë **burra**, ndërsa tek profesorët asistentë **5** janë **burra** dhe **4** janë **gra**.

PUBLIKIMI I PUNIMEVE ME KOEFICIENT

Ky fakultet numëron gjithsej 6 punime me koeficient, të publikuara nga profesorët si autorë të parë ose korrespondentë. Pjesëmarrja në punime me koeficient ³ është 11. Punimet janë publikuar nga viti 2009 deri në vitin 2019.

PUBLIKIMI NË REVISTA ME KOEFICIENT




³ Pjesëmarrja në punime paraqet numrin e punimeve ku profesorët marrin pjesë si autorë pavarësisht renditjes, pra jo vetëm si autor i parë apo korrespondent

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA

Profesorët në këtë fakultet, kanë publikuar gjithsej 18 punime në revista të dyshimta në periudhën kohore 2011 – 2018.

Këto punime janë publikuar nga 8 profesorë, 2 që i justifikojnë titujt dhe 6 që nuk i justifikojnë. 2 prej profesorëve janë të asocuar dhe 6 janë profesorë asistentë. 5 nga profesorët që kanë botuar në revista të dyshimta janë burra dhe 3 janë gra.

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Prej 11 profesorëve, 4 i justifikojnë titujt akademikë dhe 7 nuk i justifikojnë. Nga ata që i justifikojnë titujt, të gjithë janë profesorë asistentë; 2 janë burra dhe 2 janë gra. Ndërsa në radhët e profesorëve që nuk i justifikojnë titujt, 2 janë të asocuar dhe 5 janë profesor asistentë; 5 janë burra dhe 2 janë gra.

Profesorët që i justifikojnë titujt			Profesorët që nuk i justifikojnë titujt		
Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg	Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg
4	0	0	5	2	0

FAKULTETI JURIDIK



Fakulteti Juridik ka **7 profesorë**, **një** prej të cilëve është profesor i asocuar dhe **6** janë **profesorë asistentë**. **Të gjithë** profesorët e Fakultetit Juridik janë **burra**.

PUBLIKIMI I PUNIMEVE ME KOEFICIENT


Ky fakultet numëron gjithsej 2 punime me koeficient të publikuara nga profesorët si autorë të parë ose korrespondentë. Punimet janë publikuar në vitin 2015. Nuk ka pjesëmarrje në punime të tjera.

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA

Profesorët në këtë fakultet kanë publikuar gjithsej 11 punime në revista të dyshimta, në periudhën kohore 2014 - 2019.

Këto punime janë publikuar nga 5 profesorë, një që e justifikon titullin dhe 4 që nuk e justifikojnë titullin. Një prej profesorëve është i asocuar dhe 4 janë profesorë asistentë. Të gjithë profesorët që kanë botuar në revista të dyshimta janë burra.

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Prej 7 profesorëve, një profesor asistent e justifikon titullin. Ndërsa 6 profesorë të tjerë nuk i justifikojnë titujt, një i ascouar dhe 5 asistentë, të gjithë burra.

Profesorët që i justifikojnë titujt			Profesorët që nuk i justifikojnë titujt		
Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg	Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg
1	0	0	5	1	0

FAKULTETI EKONOMIK



Fakulteti Ekonomik ka **13 profesorë**, **10** prej të cilëve janë **burra** dhe **3** janë **gra**. **5 profesorë** janë të asocuar, ndërsa **8** janë **profesorë asistentë**. Të gjithë profesorët e asocuar janë **burra**, ndërsa tek profesorët asistentë, **5** janë **burra** dhe **3** janë **gra**.

PUBLIKIMI I PUNIMEVE ME KOEFICIENT

Ky fakultet numëron gjithsej 4 punime me koeficient, të publikuara nga profesorët si autorë të parë ose korrespondentë. Pjesëmarrja në punime me koeficient ⁴ është 5. Punimet janë publikuar nga viti 2007 deri në vitin 2018.


PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA

Profesorët në këtë fakultet kanë publikuar gjithsej 46 punime në revista të dyshimta në periudhën kohore 2008 - 2018. Viti me më së shumti punime të tilla, është 2016 me 18 sosh.

Këto punime janë publikuar nga 11 profesorë, një që e justifikon titullin dhe 10 që nuk e justifikojnë. 4 prej profesorëve janë të asocuar dhe 7 janë profesorë asistentë. 9 nga profesorët që kanë botuar në revista të dyshimta janë burra dhe 2 janë gra.

⁴ Pjesëmarrja në punime paraqet numrin e punimeve ku profesorët marrin pjesë si autorë pavarësisht renditjes, pra jo vetëm si autor i parë apo korrespondent

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Prej 13 profesorëve, 2 i justifikojnë titujt akademikë dhe 11 nuk i justifikojnë. Nga ata që i justifikojnë titujt, të gjithë janë profesorë asistentë; 1 është burrë dhe një është grua. Ndërsa në radhët e profesorëve që nuk i justifikojnë titujt, 5 janë të asocuar dhe 6 janë asistentë; 9 janë burra dhe 2 janë gra.

Profesorët që i justifikojnë titujt			Profesorët që nuk i justifikojnë titujt		
Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg	Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg
2	0	0	6	5	0

FAKULTETI I FILOLOGJISË




Fakulteti i Filologjisë ka **11 profesorë**, 7 prej të cilëve janë **burra** dhe **4** janë **gra**. **2** profesorë janë të asocuar, ndërsa **9** janë profesorë asistentë. Tek profesorët e asocuar, **një** është **burrë** dhe **një** është **grua**, ndërsa tek profesorët asistentë, **6** janë **burra** dhe **3** janë **gra**.

PUBLIKIMI I PUNIMEVE ME KOEFICIENT

Ky fakultet numëron gjithsej 9 punime me koeficient, të publikuara nga profesorët si autorë të parë ose korrespondentë. Punimet janë publikuar nga viti 2014 deri në vitin 2019. Nuk ka pjesëmarrje në punime të tjera.

PUBLIKIMI NË REVISTA ME KOEFICIENT




PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA

Profesorët në këtë fakultet kanë publikuar gjithsej 19 punime në revista të dyshimta në periudhën kohore 2013 - 2019. Viti me më së shumti punime të tilla është 2017 me 9 sosh.

Këto punime janë publikuar nga 4 profesorë, një që e justifikon titullin dhe 3 që nuk e justifikojnë. 2 prej profesorëve janë të asocuar dhe 2 janë profesorë asistentë. Dy nga profesorët që kanë botuar në revista të dyshimta janë burra dhe 2 janë gra.

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA



JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Prej 11 profesorëve, 2 i justifikojnë titujt akademikë dhe 9 nuk i justifikojnë. Nga ata që i justifikojnë titujt, të gjithë janë profesorë asistentë dhe të gjithë janë burra. Ndërsa në radhët e profesorëve që nuk i justifikojnë titujt, 2 janë të asocuar dhe 7 janë asistentë; 5 janë burra dhe 4 janë gra.

Profesorët që i justifikojnë titujt			Profesorët që nuk i justifikojnë titujt		
Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg	Prof.ass	Prof.asoc.	Prof.rreg
2	0	0	7	2	0

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT TË PUNIMEVE SHKENCORE

Baza Ligjore

- ① Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës⁵
- ② Statuti i Universitetit të Prizrenit, gjegjësisht Nenet 171, 172 dhe 173⁶
- ③ Udhëzimi Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension⁷
- ④ Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe precizimin – (Aneksi –I MASHT) 07/2018 e Udhëzimit Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension⁸

ORCA ka shqyrtuar një mori dokumentesh relevante të implementuara nga organe të larta ligjvënëse në vend, siç është Parlamenti i Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Më konkretisht është analizuar Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë, pastaj Udhëzimet Administrative 01/2018 dhe UA 07/2018. Për më tepër, ORCA ka bërë analizimin e publikimeve në revista shkencore ndërkombëtare, të përcaktuara si kriter nga Statuti i Universitetit të Prizrenit, për zgjedhjen dhe emërimin e titujve akademikë.

5 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761>

6 [https://uni-prizren.com/repository/docs/Statuti_i_Universitetit_-_Ukshin_Hoti_-_Shqip_\(1\)_202298.pdf](https://uni-prizren.com/repository/docs/Statuti_i_Universitetit_-_Ukshin_Hoti_-_Shqip_(1)_202298.pdf)

7 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/01/ua-nr-01-2018-parimet-e-njohjes-se-platoformave-dhe-revistave-nder-kombetare-me-recension.pdf>

8 https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/05/ua-7-2018-per-plotesimin-dhe-precizimin-e-ua-parimet-e-njohjes-per-revitat-nderkombetare_1.pdf

OBJEKTI I SHQYRTIMIT

Për përpilimin e këtij raporti, janë analizuar të dhënat e 6 fakulteteve të Universitetit të Prizrenit; ai i Shkencave Kompjuterike, Juridik, Ekonomik, i Edukimit, i Filologjisë dhe Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit. Këtu nuk përfshihen asistentët, ligjëruesit, lektorët dhe bashkëpunëtorët e tjerë, të cilët nuk i kanë titujt akademikë profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt.

PERIUDHA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE

Procesi i hulumtimit të publikimit shkencor, është realizuar gjatë muajit gusht të 2019-ës në bazë të informatave të publikuara në ueb-faqe. Verifikimi dhe përditësimi i fundit është bërë në tetor 2019. Hulumtimi është realizuar në bazë të shqyrtimit të të gjitha CV-ve në ueb-faqen e Universitetit të Prizrenit, www.uni-prizren.com. Përveç kësaj, janë shqyrtuar edhe publikimet e listuara në faqen 'Publikimet shkencore të stafit akademik'⁹, si dhe në rubrikën 'publikimet' në faqet e profesorëve në secilin fakultet. Të dhënat e hulumtimit, u janë nënshtruar rishqyrtimit nga kolegji i ORCA-s. Të gjitha ndryshimet janë evidentuar gjatë takimit në kolegji, ku prezent ishte i gjithë stafi hulumtues i ORCA-s dhe rrjedhimisht të dhënat e analizës së hulumtimit janë përditësuar në bazë të kritikave relevante.

SHQYRTIMET E REVISTAVE

Në bazë të legjislacionit të vendit për arsimin e lartë, më përkatësisht UA1/2018 dhe UA7/2018, ORCA ka vendosur koeficient për secilin punim. Koeficientet janë përcaktuar sipas databazave ku janë të indeksuara revistat me koeficient 1. ORCA ka vlerësuar me koeficient 0, të gjitha punimet të cilat kanë qenë të publikuara në revista dhe botues të dyshimtë, si dhe ato të cilat nuk janë të indeksuara në ndonjërin prej 5 platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, siç përshkruhet tek UA 1/2018, neni 3.1.

Vlen të theksohet se punimet të cilat janë publikuar në revista të dyshimta, e të cilat në kohën e publikimit kanë qenë të indeksuara në Scopus dhe Web of Science, atëherë këto punime janë vlerësuar si pozitive. Për më tepër, ORCA ka barasvlerësuar me koeficient 0

⁹ <https://uni-prizren.com/sq/publikimet-shkencore-te-stafit-akademik>

punimet e publikuara në përmbledhje konferencash, raportet, projektet, librat apo kapituj librash të cilët nuk cilësohen si punime shkencore nga revista ndërkombëtare, si dhe punimet të cilat janë në proces e sipër të publikimit. Punimet e publikuara në revista vendore, janë përjashtuar nga vlerësimi pozitiv, si dhe ato rajonale, të cilat nuk janë të indeksuara në njërin nga platformat kredibile si Web of Science dhe Scopus.

Duke u bazuar në UA 7/2018, Neni 2, pika 4.2, në të cilën thuhet se revista nga shkencat e albanologjisë mund të jetë vendore apo e Shqipërisë, nëse ka redaksi ndërkombëtare, atëherë ajo është barasvlerësuar me koeficient 1.

Procesi i hulumtimit të të gjitha CV-ve, është bërë nga një hulumtues i vetëm i ORCA-s. Me kujdes të shtuar, hulumtuesi ka verifikuar secilën CV dhe punim shkencor që është listuar në uebfaqe të Universitetit. E gjithë kjo, për të verifikuar në rast se punimi është botuar në revistat e indeksuara nga 5 platformat me recension apo është botuar në njërin nga revistat e dyshimta apo të botuesve të dyshimtë, që janë në “Listat e Beall-it”.¹⁰¹¹

10 <https://web.archive.org/web/20170111172309/https://scholarlyoa.com/individual-journals/>

11 <https://web.archive.org/web/20170111172306/https://scholarlyoa.com/publishers/>

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT TË JUSTIFIKIMIT TË TITUJVE

Janë analizuar 56 CV të stafit të rregullt akademik të Universitetit të Prizrenit, si dhe publikimet e tyre të listuara në uebfaqe të Universitetit. Procesit të analizimit iu janë nënshtruar 6 Fakultete. Ky hulumtim anashkalon asistentët, ligjëruesit, lektorët dhe bashkëpunëtorët e tjerë të cilët nuk i gëzojnë titujt akademikë si profesor asistent, profesor i asocuar dhe profesor i rregullt.

Analizimi i CV-ve të stafit akademik, si dhe i publikimeve në uebfaqe, është bërë në përputhshmëri të plotë me dispozitat ligjore të Kosovës për arsimin e lartë, më konkretisht, Udhëzimi Administrativ 1/2018, mbi revistat ndërkombëtare me recension dhe Statutit të Universitetit të Prizrenit.

Titulli akademik, Profesor i Rregullt¹² ndër të tjera precizon se për këtë gradë akademike kandidati duhet të ketë doktoratën dhe të paktën 5 punime të publikuara në revista shkencore si autor i parë ose korrespondent.

Titulli akademik, Profesor i Asocuar¹³ ndër të tjera thotë se për këtë gradë akademike kandidati duhet të ketë doktoratën dhe të paktën 3 punime të publikuara në revista ndërkombëtare si autor i parë ose korrespondent.

Titulli akademik, Profesor Asistent¹⁴ ndër të tjera specifikon se për këtë gradë akademike kandidati duhet të ketë doktoratën dhe të paktën 1 punim të publikuar në revista ndërkombëtare si autor i parë ose korrespondent.

¹² Neni 171, pika 1.1 dhe 1.2.1, Statuti i Universitetit të Prizrenit,

¹³ Neni 172, pika 1.1 dhe 1.2, Statuti i Universitetit të Prizrenit

¹⁴ Neni 173, pika 1.1 dhe 1.2, Statuti i Universitetit të Prizrenit

DEKLARATË E MOHIMIT TË PËRGJEGJËSISË:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencioni Austriak për Zhvillim. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencionit Austriak për Zhvillim.

WITH FUNDING FROM
 AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministërstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologji
Ministry of Education, Science and Technology

